

## **Si aplikohet për Ndhimën Ekonomike në qarqet e projektit pilot?**

### **Ku duhet të drejtoheni për të kërkuar Ndhimën Ekonomike?**

Ndhimja Ekonomike kërkohet pranë komunës apo bashkisë ku jetoni dhe keni gjendjen civile. Punonjësi përgjegjës për marrjen e kërkesës suaj është administratori shoqëror.

### **Kur duhet bërë kërkesa herën e parë?**

Kërkesa bëhet nga data 1-10 të cdo muaji. Në rast se kërkesa plotësohet mbas 10 (dhjetë) ditëve të para ajo ruhet dhe bëhet e vlefshme për muajin pasardhës.

### **Si plotësohet kërkesa herën e parë?**

Kërkesa plotësohet sëbashku me administratorin shoqëror në momentin e dorëzimit të dokumenteve, në prezencë të të dy bashkëshortëve, përveçse rasteve kur janë në proces zgjidhjeje martesore, ose kur kërkuesit janë jetimë, viktimë të trafikimit ose viktimë të dhunës në marrëdhënie familjare.

Mbasi plotësohet kërkesa, ju keni të drejtë të kontrolloni informacionin e hedhur nëse nuk është i saktë dhe të kërkonit që të ndryshohet.

Kur kërkesa është e plotësuar në mënyrë të saktë ju duhet ta nënshkruani dhe administratori shoqëror do t'ju japë një kopje të faqes së parë të kësaj kërkesë.

### **Çfarë përmban kërkesa?**

Kërkesa përmban një sërë pyetjesh, të cilat kanë për qëllim vlerësimin e gjendjes reale ekonomike. Këto pyetje kanë të bëjnë me numrin e anëtarëve të familjes, arsimimin dhe punësimin e tyre; llojin e banesës, pasuritë dhe objekte të tjera në pronësi, si dhe të ardhura nga programet e mbrojtjes shoqërore dhe të ardhurat e tjera.

### **Çfarë dokumentesh duhet të dorëzoni bashkë me kërkesën e parë për Ndhimë Ekonomike?**

Dokumentet që duhet të dorëzoni tek administratori shoqëror për kërkesën e parë për Ndhimë Ekonomike janë sipas rasteve më poshtë:

#### **1. Familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme:**

- ✓ Kopjen e kartave së identitetit të të gjithë anëtarëve të familjes që kanë karta identiteti;
- ✓ Çertifikatën familjare që lidhet të gjithë ata persona që janë pjesë e së njëjtës gjendje familjare;
- ✓ Çertifikatën e pronësisë, të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme apo aktin e marrjes në pronësi ose në përdorim të tokës (tapinë e tokës), për zonat ku regjistrimi i pronësisë nuk ka përfunduar ende;

Familjet me fëmijë nën moshën madhore edhe:

- vërtetim mbi frekuentimin e shkollës për fëmijët që ndjekin arsimin e detyrueshëm,
- dëftesën e kalueshmërisë,
- kalendarin e kryerjes së vaksinave për fëmijët.

\* Në rastet kur bashkëshortët janë në proces zgjidhjeje martese dhe ende nuk ka një vendim

gjykate të formës së prerë, dokumentacioni paraqitet i ndarë nga secili bashkëshort. Në këtë rast duhet që të dorëzohet edhe vërtetimi i gjykatës që bashkëshortët janë në proces zgjidhjeje martesore.

\*\* Në rastet kur një ose më shumë anëtarë të familjes janë me aftësi të kufizuar ose invalidë duhet që të dorëzohet edhe kopje e vërtetimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë.

**2. Jetimët që nuk janë në institucione të përkujdesit shoqëror:**

- ✓ Kopjen e kartës së identitetit;
- ✓ Çertifikatën familjare;
- ✓ Kopjen e noterizuar për statusin e jetimit, sipas kërkesave të parashikuara në ligjin “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar;

**3. Prindërit e fëmijëve të lindur trinjakë e më shumë njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë:**

- ✓ Certifikatën familjare;

**4. Viktimat e trafikimit pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore deri në çastin e punësimit:**

- ✓ Kopjen e kartës së identitetit;
- ✓ Certifikatën familjare;
- ✓ Vërtetimin e trajtimit në institucionet e përkujdesjes shoqërore të lëshuar brenda 30 ditëve të fundit;

**5. Viktimat e dhunës në marrëdhënie familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrin të mbrojtjes ose të urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes:**

- ✓ Kopjen e kartës së identitetit;
- ✓ Certifikatën familjare;
- ✓ Urdhrin e mbrojtjes ose urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes të lëshuar nga gjykata;

\*Në çdo rast, administratori shoqëror mund t’ju kërkojë dokumente të tjera të nevojshme, për të përcaktuar të ardhurat familjare.

**A verifikohen dokumentet dhe informacioni që jepet gjatë plotësimit të kërkesës?**

Po, dokumentacioni dhe informacioni i dhënë gjatë plotësimit të kërkesës verifikohet në mënyrë elektronike me institucionet e tjera shtetërore, si dhe fizikisht në vendbanim. të paktën dy herë në vit.

Në rast të deklaratave të rreme, kërkesa për Ndihmë Ekonomike nuk do të pranohet.

**Po kur ka mungesa në dokumentet ose në plotësimin e kërkesës për herë të parë?**

Në rastet kur ka mungesa në dokumentet e nevojshme për të bërë kërkesën, ose në informacionin e nevojshëm për plotësimin e kërkesës, administratori shoqëror duhet t’ju njoftojë, duke ju dhënë edhe një listë të mungesave.

Në rast se ju nuk mundeni të plotësoni mungesat në dokumentacion dhe informacion brenda 10 (dhjetë) ditëve të para të muajit, atëherë kërkesa juaj ruhet për muajin pasardhës. Administratori shoqëror duhet t'ju ruajë kërkesën e çelur bashkë me dokumentacionin e dorëzuar deri në 30 (tridhjetë) ditë.

Në rast se ju nuk plotësoni dokumentacionin dhe informacionin brenda 30 (tridhjetë) ditëve, atëherë administratori shoqëror ka të drejtë ta anulojë kërkesën.

### **Kur përjashtohesh nga Ndhima Ekonomike?**

Nga Ndhima Ekonomike mund të përjashtohesh nëse:

- ✓ Dokumentacioni ose informacioni i dhënë gjatë plotësimit të kërkesës rezulton i rremë pas kontrollit në mënyrë elektronike me institucionet e tjera shtetërore dhe të verifikimit fizik në vendbanim.
- ✓ Ju nuk pranoni të intervistoheni në vendbanimin e deklaruar pas dy njoftimeve të bera nga administratori.
- ✓ Një prej anëtarëve të familjes ndahet qëllimisht nga trangu familjar pa krijuar një kurorë të re, përveç rasteve të vajzave nëna;

### **Si përzgjidhesh si përfitues i Ndimës Ekonomike?**

Mbas mbylljes së aplikimeve sistemi elektronik, mbasi kontrollon dhe peshon informacionin në dokumentacionin dhe kërkesën e paraqitur pranë administratorit shoqëror, përcakton renditjen për të qenë përfitues ose jo të Ndimës Ekonomike.

### **Si lajmërohesh nëse je përzgjedhur?**

Ju mund të kërkon informacion për pranimin apo refuzimin e saj pranë komunës apo bashkisë tuaj, në përfundim të muajit për të cilin kërkesa juaj është e vlefshme.

### **Kush ka të drejtë të tërheqë dhe pagesën e Ndimës Ekonomike?**

Pagesa e Ndimës Ekonomike tërhiqet nga bashkëshortja e familjes në nevojë dhe nga vetë individi në nevojë.

### **Ku tërhiqet Ndhima Ekonomike?**

Pagesa e Ndimës Ekonomike tërhiqet pranë zyrave të postës ose sporteve të bankave.

### **Çfarë duhet bërë për të vazhduar marrjen e Ndimës Ekonomike mbasi jam përzgjedhur?**

Të dy bashkëshortët duhet të paraqiten çdo 3 (tre) muaj pranë bashkisë apo komunës ku jetojnë dhe kanë gjendjen civile dhe sëbashku me administratorin shoqëror të plotësojnë një deklaratë, mbi çdo ndryshim të situatës së tyre, nëse ka ndryshuar.

Në përfundim të 2 (dy) viteve nga plotësimi i kërkesës së parë, ju duhet të dorëzoni sërish dokumente për situatën tuaj shoqërore ekonomike dhe të plotësoni sërish kërkesën e plotë.

### **A mund të përfitoj shtesa në Ndimë Ekonomike?**

Po, me anë të ndjekjes së rregullt të arsimit të detyrueshëm dhe kryerjes së kalendarit të vaksinimeve nga fëmijët e familjes, mund të ketë shtesa në pagesën e Ndimës Ekonomike.

**A kushtëzohet Ndihma Ekonomike?**

Po, marrja e Ndhmës Ekonomike kushtëzohet nëpërmjet marrjes pjesë në punë apo shërbime komunitare të personave në moshë pune, anëtarë të familjes.

**Po nëse je përzgjedhur sipas mënyrës së mëparshme?**

Në këtë rast, dosja juaj është e plotësuar tashmë pranë administratorit shoqëror dhe ju duhet të aplikoni sipas mënyrës së re elektronike.

**Po nëse ndryshohet vendbanimi?**

Në rastet kur ju ose familja juaj ndryshoni vendbanim, krahas ndryshimit të gjendjes civile, transferohet edhe dosja e ndihmës ekonomike në bashkinë apo komunën e re, e cila duhet të jetë brenda qarqeve të Tiranës, Durrësit ose Elbasanit.

Në rast se vendbanimi juaj i ri nuk është në këto qarqe, atëherë kërkesa juaj duhet të bëhet sipas mënyrës së mëparshme.

**A mund tëankohesh nëse nuk përzgjidhesh?**

Në rastet kur kërkesa juaj është refuzuar, ju duhet të kërkonit pranë bashkisë apo komunës tuaj informacion për arsyet e refuzimit.

Ju keni të drejtën për të ankimuar me shkrim te Drejtori i Zyrës Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, i cili ju njofton me shkrim për vendimin e marrë. Më pas ju keni të drejtën të ankimoni në gjykatë vendimin për refuzim të Ndhmës Ekonomike.